



Strategjia e OPED 2024-2027

Kjo strategji është mundësuar falë mbështetjes organizative të Fondit të Grave të Kosovës (FGK), përmes Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) dhe është financuar nga Sigrid Rausing Trust (SRT). Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Organization for Partnership Engagement and Development (OPED) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e SRT apo RrGK.

© Organization for Partnership Engagement and Development (OPED),

Korrik 2023

**THE
SIGRID
RAUSING
TRUST**



PËRMBAJTJA

HYRJE	3
PËR OPED-NË	3
VIZIONI.....	3
MISIONI	3
METODOLOGJIA.....	3
ANALIZA KONTEKSTUALE	4
SWOT ANALIZA.....	4
PËRPARËSITË.....	5
DOBËSITË	5
MUNDËSITË.....	6
KËRCËNIMET.....	6
OBJEKTIVAT E STRATEGJISË	7
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 1: NGRITJA E LLOGARIDHËNIES INSTITUCIONALE DHE DEMOKRACISË NË NIVEL LOKAL	7
BAZA LIGJORE.....	7
SITUATA.....	10
SFIDAT KRYESORE.....	11
PËRFITUESIT, PARTNERËT DHE PËRKRAHËSIT.....	11
STRATEGJIA E OPED	12
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 2: AVANCIMI PROFESIONAL DHE EDUKIMI JOFORMAL I TË RINJVE NË NIVEL LOKAL	14
BAZA LIGJORE.....	14
SITUATA.....	14
SFIDAT KRYESORE.....	15
PËRKRAHËSIT DHE PËRFITUESIT.....	15
STRATEGJIA E OPED	15
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 3: PËRMIRËSIMI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE TË GJELBËRTA	16
BAZA LIGJORE.....	16
SITUATA.....	16
SFIDAT KRYESORE.....	17
PËRKRAHËSIT DHE PËRFITUESIT.....	17
STRATEGJIA E OPED	17
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 4: NGRITJA E KAPACITETEVE TË OPED-SË.....	20
BAZA LIGJORE.....	20
SITUATA.....	20
SFIDAT KRYESORE.....	20
PËRKRAHËSIT DHE PËRFITUESIT.....	21
STRATEGJIA E OPED-SË	21

HYRJE

Ky dokument ka për qëllim të listojë prioritetet strategjike të identifikuar nga OPED për fushëveprimin organizativ në periudhën 2024-2027. Strategjia e OPED synon t'i jetësojë objektivat dhe propozimet e akterëve për promovimin e parimeve demokratike, në pajtim me misionin dhe statutin e organizatës, duke integruar dukshëm ngritjen e nivelit të llogaridhënies dhe demokracisë, perspektivën gjinore dhe atë të ruajtjes së ambientit, në objektivat e identifikuar.

PËR OPED

OPED është Organizatë joqeveritare e themeluar në komunën e Podujevës në vitin 2016, e cila synon që përmes angazhimit aktiv në shoqëri, nismave avokuese, monitorimit institucional dhe gjithëpërfshirjes sociale të promovojë vlera dhe praktika demokratike duke kontribuar kundrejt rritjes së transparencës institucionale, arritjes së barazisë gjinore dhe vetëdijësimit qytetar, me anë të ndikimit në politikat publike lokale dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik lokal. Mbrojtja e ambientit zë poashtu një vend kyq në fushëveprimtarinë e OPED.

VIZIONI

Vizioni i OPED konsiston në angazhimin e organizatës drejt: Qeverisjes lokale me përfshirje qytetare, duke reflektuar nevojat e ndryshme të burrave dhe grave, të nivelit lokal. OPED, përmes vizionit të vet, synojë të kontribuojë në krijimin e një qytetarie aktive, të përgjegjshme për mjedisin, dallimet ekonomike-sociale, dhe të zëshme në artikulimin e prioriteteve të saj. OPED synon të realizojë vizionin e përcaktuar këtu, përmes objektivave të identifikuar në këtë strategji tri vjeçare, mirëpo edhe përmes implementimit të iniciativave individuale, të cilat OPED planifikon t'i realizojë përgjatë këtyre viteve, e të cilat domosdo do t'i kontribuojnë objektivave të kësaj strategjie dhe jetësimit të vizionit të OPED.

MISIONI

OPED, angazhohet për qytetari aktive, në promovim të vlerave dhe praktikave demokratike, që ndikojnë në mirëqeverisje të institucioneve, në veçanti të qeverisjes lokale duke rritur transparencën, barazinë gjinore dhe duke nxitur organizime të mirëfillta në mbrojtje të mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

METODOLOGJIA

Strategjia e OPED 2024-2027, është hartuar me propozimet e përfaqësuesve të vetë organizatës dhe të kuvendit të anëtarëve të saj, partnerëve e donatorëve të OPED. Në koordinim me këta akterë, OPED ka përpiluar një listë të prioriteteve, të bazuar në bagazhin e veprimtarisë së organizatës – përkatësisht, projekteve paraprake dhe atyre aktuale, të cilën listë e ka ndarë me ekspertin kontraktues për vizualizimin e kësaj strategjie në objektivë dhe indikatorë konkretë, për vitin 2024-2027. OPED përgjatë këtij procesi ka mbajtur një sërë takimesh konsultative me anëtarët e organizatës dhe përfaqësuesit e Rrjetit të Grave të Kosovës, për t'u siguruar që është përfshirë mjaftueshëm perspektiva gjinore si dhe ajo ndërthurëse, përgjatë strategjisë.

Gjatë procesit të hartimit të planit strategjik për OPED 2024-2027 janë përdorur dhe referuar të dhënat nga publikimet, korniza ligjore kombëtare dhe materiale relevante në lidhje me situatën aktuale në katër objektivat e përzgjedhura për OPED. Në masë të konsiderueshme, OPED në përpilimin e kësaj

strategjie ka tërënjësi edhe nga përvoja e vet në terren, me gjetje dhe analiza të konsoliduara përmes pjesëmarrjes në komunitetin në të cilin organizata ndërvepron.

Pas analizës së të dhënave në dispozicion janë nxjerrë përfundimet në bazë të së cilave janë identifikuar objektivat specifike që përcaktojnë orientimet strategjike për adresimin e sfidave në periudhën 2024-2027.

ANALIZA KONTEKSTUALE

SWOT ANALIZA

Njëri nga aktivitetet e realizuara në kuadër të punës planifikuese ishte analiza e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të cilët kanë ndikim në veprimtarinë e OPED dhe realizimin progresiv dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatës. Kjo analizë gjithashtu ka ofruar bazën për të identifikuar mundësitë dhe rreziqet në secilin aspekt, në të cilat grupi punues është thelluar edhe më shumë në punëtoritë e radhës përmes SWOT analizës dhe analizës së akterëve. Analiza poashtu në thelb është bazuar në parimet dhe objektivat të cilat rrjedhin edhe nga konteksti i dokumenteve ekzistuese, të cilat kanë në plan të avancojnë barazinë gjinore në Kosovë, përfshirë këtu:

- Objektivat e zhvillimit të Qëndrueshëm¹, me theks Objektivin nr.5 për barazi Gjinore dhe Objektivit nr.13 për ndërmarrjen e aksioneve drejt ndryshimeve klimatike²;
- Planin e Veprimit Gjinor III – sidomos Planin e Veprimit Gjinor në nivel vendi;³
- Programin Kombëtar për Barazi Gjinore 2020-2024, në pajtim me Objektivin Strategjik 1: “Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në /nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale;⁴

Në shoqëritë e sotme vazhdimisht dinamike dhe të ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore, sociale, politike, ekonomike, duhet të kihet parasysh ndikimet e jashtme të cilat mund të ndikojnë në veprimtarinë e entiteteve të ndryshme juridike, përfshirë këtë të organizatave të shoqërisë civile. Prandaj, për të analizuar sa më qartë kontekstin në të cilin OPED ndërvepron, dhe për të pasur më mirë parasysh këto dinamika zhvillimore, OPED ka hartuar strategjinë duke aplikuar edhe metodën e analizës SWOT, mes tjerash.

Gjatë diskutimit dhe konsolidimit të prioriteteve organizative, OPED ka analizuar Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet të cilat organizata parasheh se posedon, dhe/ose do t'i përballojë përgjatë veprimtarisë së planifikuar brenda tre viteve të implementimit të kësaj strategjie. Më poshtë listohen konkluzionet e grupit punues.

¹Kuvendi i Kosovës, [Objektivat për Zhvillim të Qendrueshëm](#)

² United Nations, Department of Economic and Social Affairs , Sustainable Development, [The 17 Goals](#)

³ European Union, Gender Action Plan III – 2021-2025, Country Level Implementation Plan for Kosovo, Green Transition and Digitalization

⁴ Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#)

PËRPARËSITË

Organizata OPED vepron në nivel lokal. Si e tillë, ajo njeh komunitetin në të cilin ndërvepron, njeh institucionet e nivelit lokal, si dhe rrethanat në të cilat OPED planifikon t'i realizojë aktivitetet e veta, në kuadër të kësaj Strategjie.

Qasja e organizatës konsiston në parime bashkëkohore të cilat përkojnë me kërkesat e Bashkimit Evropian në lidhje me sundimin e ligjit dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përkatësisht, fokusi i OPED është: **1) Sundimi i Demokracisë, 2) Barazia Gjinore, 3) Mbrojtja e Ambientit dhe 4) Punësimi i të rinjëve**, vlera dhe parime të cilat OPED do të tentojë t'i përfshijë në mënyrë të përgjithshme përgjatë implementimit të kësaj Strategjie.

Organizata ka një përbërje diverse të stafit, si në aspektin e përbërjes gjinore, poashtu edhe në aspektin e ekspertizës së secilit prej të punësuarve në organizatë, të cilët i kontribuojnë në mënyrë të vazhdueshme jetësimit të objektivave të strategjisë.

OPED tashmë ka një bagazh të pasur me përkrahës, partnerë dhe donatorë, të cilët kanë krijuar marrdhënie stabile me OPED dhe kanë krijuar tashmë mirëbesim në aspektin e implementimit të iniciativave. OPED poashtu ka një numër të konsiderueshëm të aktivistëve dhe vullnetarëve.

- Fokus Specializuar: Fokusi i veçantë i organizatës në monitorimin e politikave mjedisore publike me perspektivë gjinore i lejon atij të adresojë çështje kritike në nivel lokal, duke kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm dhe barazi gjinore.
- Themelimi i hershëm: Duke u themeluar në vitin 2017, organizata ka avantazhin e ideve dhe qasjeve relativisht të reja, duke i mundur adaptimin shpejt ndaj sfidave dhe mundësive të emergjencave.
- Përvojë në Projekte: Pavarësisht se është relativisht e re, organizata ka zbatuar tashmë afërsisht 15 projekte, duke treguar aftësi për veprim dhe punë efikase në terren.
- Perspektiva Gjinore: Përfshirja e një perspektive gjinore në monitorimin e politikave publike është një forcë unike që ndihmon në sigurimin që politikat marrin parasysh nevojat e ndryshme dhe promovojnë përfshirjen në proceset e vendimmarrjes.
- Marrëdhënie të Mira me Qeverisjen Lokale: Marrëdhëniet pozitive të organizatës me qeverisjen lokale ofrojnë mundësi për bashkëpunim, ndikim dhe njohje më të mirë të proceseve të krijimit të politikave.
- Fushata Aktivizmi të Ndryshme: Pjesëmarrja e vullnetarëve nga fusha të ndryshme të aktivizmit sjell ekspertizë të ndryshme, perspektiva dhe aftësi për të adresuar aspekte të ndryshme të çështjeve mjedisore dhe gjinore.

DOBËSITË

- Mungesa e Liçencimit: Paaftësia e organizatës për të ofruar shërbime sociale për shkak të mungesës së liçencimit mund të kufizojë zonën e tij të ndikimit në terren, veçanërisht në kohë të krizave ose emergjencave.
- Burime të Kufizuara: Duke qenë organizatë relativisht e re me numër të vogël vullnetarësh, burime financiare dhe njerëzore të kufizuara mund të pengojnë shkallën dhe ndikimin e projekteve dhe iniciativave.
- Portofoli i Projekteve të Kufizuara: Për shkak të kufizimit të numrit të projekteve të zbatuara deri më tani, organizata mund të kufizohet në kredibilitetin dhe përvojën e saj në sytë e dhuruesve potencialë, partnerëve dhe palëve të interesit.

- Fusha e fokusit: OPED është e fokusuar në fusha të ndryshme të avokimit, të cilat shpeshherë mund të përbëjnë sfidë në aspektin e fokusimit në këto fusha, dhe në të njëjtën kohë, mund të paraqesë sfidë ndërlidhshmëria mes tyre. Shembull: Ndërlidhshmëria e Eko-turizmit dhe barazisë gjinore, të cilat në fakt janë të ndërlidhura mirëpo ekspertiza e stafit të OPED mbi ndërlidhjen e tyre është e kufizuar.
- Kohëzgjatja e projekteve: Projektet afat-shkurtra, të cilat ndonjëherë e bëjnë të vështirë arritjen e ndryshimeve sociale;
- Infrastruktura e rrjeteve sociale: në aspektin e komunikimit me publikun, përfshirë këtu mungesën e një webfaqeje, buletini informativ, Strategjisë për marrdhënie me publikun, apo të ngjashme, të cilat mund të kufizojnë nivelin e arritjes së OPED tek target grupet e veta;
- Njohuritë e kufizuara të koncepteve më të komplikuara të barazisë gjinore: të cilat do të mund t'i shërbenin organizatës në aspektin e vetëdijësimit qytetar në lidhje me barazinë gjinore.

MUNDËSITË

- Rritja e Ndërrgjegjësimit: Ndërrgjegjësimi i rritur për çështjet mjedisore dhe gjinore në nivel lokal dhe global paraqet një mundësi për organizatën për të përdorur interesin dhe mbështetjen e publikut për iniciativat e saj.
- Bashkëpunimi dhe Partneritetet: Organizata mund të eksplorojë bashkëpunimin me OJQ tjera lokale, akademike dhe institucionet e kërkimit për të bashkuar burime, ndarë njohuri dhe rritur efektivitetin e punës së tyre.
- Mundësi Financimi: Me një mision të bindshëm dhe projekte të provuara, organizata mund të aplikojë për grante, financime dhe mundësi sponsorizimi për të zgjeruar veprimtarinë dhe ndikimin e tyre.
- Duke qenë se funksionon në nivel lokal, organizata ka mundësi të shumta për të bërë ndryshime aktuale brenda komunitetit të qytetit të Podujevës, duke përfshirë avokimin në politikë bërjen në nivel komunal, vetëdijësimin qytetar për pjesëmarrje në politikëbërje në nivel lokal, dhe mundësinë e implementimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor.
- Organizata posedon njohuri thelbësore në aspektin e zhvillimit të eko-turizmit dhe ruajtjes së natyrës, me ç'rast ka mundësi të kontribuojë në aspektin e ruajtjes së ambientit, një aspekt tejet i nevojshëm në kontekstin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vetëqeverisjen lokale.
- Poashtu, në kuadër të ekspertizës dhe përvojës në përfshirje të hartimit të politikave publike në nivel lokal, OPED ka mundësi të ofrojë kontribut të dukshëm autoriteteve lokale drejt hartimit të politikave lokale dhe monitorimin e zbatimit të politikave të miratuara.

KËRCËNIMET

- Ndryshimet politike: Jo stabiliteti politik dhe ndryshimi i strukturave qeverisëse lokale ose kombëtare mund të ndikojë në politikat dhe burimet e financimit të organizatës, poashtu në arritjen e ndryshimeve sociale, të cilat kërkojnë avokim afatgjatë.
- Mungesa e mbështetjes së Donatorëve: OPED mund të pësojë ngecje në realizim të disa objektivave të kësaj Strategjie, nëse mbështetja financiare nga donatorët reduktohet me kalim të kohës.
- Në përgjithësi, fokusi i organizatës në monitorimin e politikave mjedisore publike me perspektivë gjinore ka potencial të madh për ndryshime pozitive në nivel lokal. Duke adresuar dobësitë si licencimi dhe burimet e kufizuara, dhe duke shfrytëzuar mundësitë përmes bashkëpunimit dhe mbledhjes së fondeve, organizata mund të përmirësojë efektivitetin e saj dhe të ketë ndikim të rëndësishëm në çështjet mjedisore dhe gjinore në komunitet.

GJITHËPËRFSHIRRJA

Sipas Planit të BE-së për Veprim Gjinor III, Një qasje është ndërthurëse (intersectional) kur bazohet në njohjen e shumë karakteristikave dhe identiteteve të një individi, për të analizuar dhe reaguar ndaj mënyrave në të cilat seksi dhe gjinia ndërthuren me karakteristika personale të tjera.⁵ Edhe Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë përmes Nenit 4 ndalon diskriminimit gjinor, duke përfshirë “trajtimin më pak të favorshëm të femrave për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, gjendjes martesore, kombësisë, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar dhe besimit, moshës, ose ndonjë bazë tjetër”.

Duke u bazuar në këto parime, OPED do të tentojë që përmes realizimit të objektivave strategjike, të konsiderojë prioritetet e ndryshme, sfidat, dhe barrierat e grupeve të tilla të marginalizuara, dhe t’i reflektojë të njëjtat në procese avokukese dhe në implementim të projekteve.

OBJEKTIVAT E STRATEGJISE

OPED ka përmbledhur kater synime kryesore për të përfshirë në Strategjinë për vitet 2024-2027. Objektivat janë përzgjedhur duke marrë parasyshë nevojat emergjente të identifikuar gjatë implementimit të projekteve paraprake, punës në terren, dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe institucionet kompetente. Nën secilin objektiv janë vendosur disa rezultate të pritshme. Veprimet e detajuara do të zhvillohen në planet vjetore operative të OPED.

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 1: NGRITJA E LLOGARIDHËNIES INSTITUCIONALE DHE DEMOKRACISË NË NIVEL LOKAL

BAZA LIGJORE

Demokracia dhe llogaridhënia

Ligji për vetëqeverisje lokale: Neni 45 i këtij ligji, mbi takimet e hapura thekson se takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion. Sipas këtij neni, anëtarëve të publikut u lejohej pjesëmarrja në takime të kuvendit të komunës, ashtu siç është paraparë në Rregulloren e punës. Ndërsa Kreu IX, mbi Demokracinë e drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së qytetarëve përcakton kushtet për Informim publik dhe konsultim (Neni 68). Ky nen thekson se çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë, dhe se njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Ky nen thekson se në takimet e kësaj natyre përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal. Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunat janë të obliguara t’i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës.⁶ Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.⁷

Ligji për Qasje në Dokumente Publike Neni 10 thekson se Secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike në bazë të kërkesës. Paragrafi 2 I këtij neni thekson se kërkesat për qasje në dokumente publike parashtrohen në çfarëdo mënyre, e cila i mundëson institucionit publik të

⁵ [Plani i Veprimit Gjinor III](#), fq. 3

⁶ Ligji për vetëqeverisje lokale, Neni 68, Paragrafi 68.4

⁷ Po aty.

identifikojë nëse posedon dokumentin publik të kërkuar. Tutje, përmes Nenit 30 mbi Informimin dhe vetëdijesimin e publikut, ky ligj thekson se Institucionet publike duhet të informojnë publikun për të drejtën për qasje në dokumente publike dhe për mënyrën në të cilën kjo e drejtë mund të ushtrohet. Rregullorja Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin e një procesi të konsultimit publik ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut, për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes publik si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe publikut.⁸

Barazia Gjinore

Ligji për Barazi Gjinore: Që nga viti 2015, një kornizë e fuqishme ligjore në Kosovë i obligon organizatat buxhetore që të bëjnë BPGj. Ligji i ri për Barazi Gjinore përkufizon BPGj-në si: Buxhetimi gjinor - është zbatimi i integritetit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së grave dhe burrave.⁹ Më tej, neni 5.1.5, i obligon të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës ta përfshijnë “buxhetimin gjinor në të gjitha fushat, si një instrument të nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve”.¹⁰ Tutje, Neni 12 i LBGJ thekson se “Të gjitha ministrinë dhe komunat janë të obliguara të caktojnë zyrtarët/et përkatës për barazi gjinore me kapacitete profesionale dhe të ndajnë burime të mjaftueshme nga buxheti, për të koordinuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji.”¹¹

Qarkorja Buxhetore: përveç kësaj, Qarkorja Buxhetore 2016/02, e nxjerrë nga Ministria e Financave, që përdoret për të informuar organizatat buxhetore për strukturën e shpenzimeve për vitin e ardhshëm, siguroi mostrat e tabelave që duhet të plotësohen nga të gjitha ministrinë dhe komunat.¹²

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshje së Stabilizim-Asociimit: Thekson se qeverisja vendore është bazuar në parimet e mirëqeverisjes, barazisë gjinore, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave dhe shqetësimeve specifike të grave, burrave, personave me aftësi të kufizuara, si dhe komuniteteve jo shumicë dhe anëtarëve të tyre.¹³

Plani i Veprimit Gjinor III 2021-2025, i miratuar në nëntor 2020, pasqyron objektivat kryesore të Strategjisë së BE-së për Barazinë Gjinore dhe përfshin barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave përmes të gjitha politikave dhe veprimeve të jashtme.¹⁴ Zyra e BE-se në Kosovë mes tjerash ka krijuar edhe një plan të veprimit në nivel vendi, për zbatimin e PVGJ-së. Ky plan thekson se BE do të synojë të arrijë objektivat e përcaktuara përmes dialogut politik dhe programeve në disa sektorë, në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë, ministrinë e linjës, komunat, dhe mekanizmat kombëtarë të barazisë gjinore.¹⁵ Meqenëse komunat përfitojnë mes tjerash edhe nga financimi i jashtëm, përkatësisht, projektet e financuara nga BE, OPED e konsideron relevante edhe pjesën e monitorimit të PVGJ-së në nivel komunal.

Shërbimet sociale

⁸ Rregullore (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, është miratuar në mbledhjen e 86 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/86, datë 29.04.2016. Neni 1;

⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, 2015, Neni 3.1.17.

¹⁰ Po aty, Neni.5.

¹¹ Po aty, Neni 12

¹² Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, Qarkorja Buxhetore 2015/02 për Komunat, 2015, marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Qarkoret-buxhetore>.

¹³ Qeveria e Kosovës, PKZMSA 2022-2026, fq. 27

¹⁴ European Commission, EU Gender Action Plan III, 2020

¹⁵ European Union Office in Kosovo, Gender Action Plan III – 2021-2025 Country Level Implementation Plan for Kosovo, 2020

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara – Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) është instrumenti i parë ndërkombëtar, ligjërshët i detyrueshëm, që ka për qëllim të mbrojë të drejtat themelore të personave me aftësi të kufizuara.¹⁶ Edhe pse Kosova nuk është zyrtarisht anëtare e KB dhe nuk ka për detyrë llogaridhënien kundrejt komitetit për monitorimin e Konventës, Kosova gjithsesi ka shprehur zotërim për të aplikuar parimet e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Ligj për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, theksojnë se komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale brenda territorit të tyre, sipas standardeve dhe politikave të Qeverisë apo ministrive përkatëse.¹⁷ Komunat janë të obliguara të identifikojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve sociale për qytetarët e komunës, të planifikojnë shërbimet, të ofrojnë financim dhe të menaxhojnë shërbimet sociale brenda komunës.¹⁸ Drejtoritë Komunale përkatëse për mirëqenie sociale janë përgjegjëse për çështjet komunale të mirëqenies sociale dhe i menaxhojnë edhe Qendrat për Punë Sociale (QPS-të). QPS-të, si akterët kryesorë të mandatuar për koordinimin dhe organizimin e sistemeve të integruara të shërbimeve sociale (në veçanti sistemeve për mbrojtje të fëmijëve), kanë përgjegjësi për të ofruar shërbime sociale dhe familjare për qytetarët në nevojë. Të gjitha komunat në Kosovë (38) kanë Qendra për Punë Sociale.¹⁹

1. Ligji për Pensionet e Invaliditetit Nr. 2003/23,²⁶ që siguron mbrojtje sociale dhe përfitimin e avantazheve sociale për personat me aftësi të kufizuara; kjo përfshin pensione për njerëzit që nuk janë në gjendje të punojnë për shkak të invaliditetit dhe përfitimet për të mbuluar shpenzimet e tyre të transportit.
2. Ligji për Mbështetjen Materiale për Familjet e Fëmijëve me aftësi të kufizuara përjetë Nr. 03/L-22,²⁷ që ofron mbështetje materiale dhe financiare për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara.
3. Ligji për Aftësinë Profesionale, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Nr. 03/L-019 dhe Ligji Nr. 05/L-078 që vendos bazat ligjore të zbatimit të politikave publike të orientuara drejt promovimit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj përfshin në Nenin 5 ndalimin e diskriminimit në punë me kujdes për aftësinë dhe njëmbëdhjetë kritere të tjera, si p.sh., gjinia, origjina ose mosha. Neni 12 i këtij ligji detyron punëdhënësit me më shumë se 50 punonjës të punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punonjës.
4. Ligji Nr. 04/L-092 Për Personat e Verbër,²⁸ që rregullon statusin ligjor të personave të verbër në Republikën e Kosovës.
5. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, që përcakton statusin dhe të drejtat e viktimave të dhunës seksuale të kryer gjatë luftës.
6. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i vitit 2015 ndalon diskriminimin e shumëfishtë në Nenin 1.10 dhe e përcakton atë si më poshtë: "Diskriminimi i shumëfishtë ndodh kur diskriminimi bazohet në çdo kombinim të shkaqeve të mbuluara nga ky ligj. Diskriminimi i shumëfishtë dhe shkaqet e shumëfishta do të interpretohen në përputhje me këtë". Në lidhje me aftësinë e kufizuar, Ligji e përmend atë si një formë të trajtimit të pasbaraztë në Nenin 1.8: "Mungesa e një përshtatjeje të arsyeshme/përputhjeje për personat me aftësi të kufizuara - në përputhje me nevojat e tyre të veçanta, konsiderohet si diskriminim bazuar në shkaqet e përcaktuara në Nenin 1 të këtij Ligji, përveç nëse kjo sjell barrën e pamundshme për personin që është i detyruar t'i ofrojë ato dhe kjo nuk është në kundërshtim me ligjshmërinë e fuqisë aktuale, duke konsideruar për këtë qëllim faktorë si përdorimi i burimeve publike të disponueshme, pjesëmarrja në jetën sociale dhe publike dhe siguri i hyrjes në vendin e punës dhe kushteve të përshtatshme të punësimit;"
7. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve

¹⁶ United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities

¹⁷ Ministria e Drejtësisë, [Analizë e Qendrave për Punë Sociale](#), Prill 2023

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

SITUATA

Demokracia dhe llogaridhënia

Nga projektet e mëparshme në terren, në komunën e Podujevës, OPED vlerëson se vetëdija qytetare dhe pjesëmarrja e tyre në politikë bërje është e ulët. Përkundër Rregullores për Konsultim me shoqërinë civile, tubimet dhe konsultimet publike nuk kanë diversitet të audiencës, përfshirë në aspektin e balancit gjinore. Tutje, qytetarët burra dhe gra nuk e kanë të qartë se si mund të ndikojnë në politikë bërje, në fushat e ndryshme në të cilat komuna drejton politikën e saj, përfshirë edhe fushat kyçe të aktiviteteve të OPED-së: mirëqenie sociale, politika të punësimit, edukimit, mjedisit – e sidomos në lidhje me shikimin e të gjitha këtyre politikave, duke alokuar buxhet të mjaftueshëm nën konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, i cili kërkohet nga Ligji për Barazi Gjinore.

Standardet minimale për procesin e konsultimit publik nuk krijojnë detyrim për të siguruar konsultimin e grave dhe burrave të ndryshëm, megjithëse kanë për synim për të “siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje jo-diskriminuese”.²⁰ Historikisht, gratë janë të nënpërfaqësuar në konsultimet publike mbi projekt-politikat dhe ligjet, duke përfshirë edhe buxhetin.²¹

Barazia Gjinore

Për çështjen e barazisë gjinore, edhe pse respektimi i parimit të barazisë gjinore në qeverisjen vendore është një detyrim ligjor, zyrtarët e barazisë gjinore komunal ballafaqohen me vullnet politik të pamjaftueshëm për të përfshirë ata në proceset e politikave, gjë që kontribuon në mungesën e perspektivës gjinore në ligjshmëri dhe politika vendore. Për më tepër, disa prej tyre kanë aftësi të dobëta për analizën gjinore dhe proceset e tjera të politikave, duke u penguar kështu që të plotësojnë përgjegjësitë e tyre, ndërsa mungesa e fuqive ekzekutive, fondeve të pamjaftueshme dhe agjendave të partive politike gjithashtu dobësojnë punën e tyre. Këto dhe detyrimet e tjera janë kërkesa që dalin nga Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së.

Shërbimet sociale

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë ndër kategoritë e marginalizuara me më së paku mbështetje dhe më të izoluarit në Kosovë. Edhe pse mungojnë të dhëna zyrtare rreth fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë, si dhe personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi, sipas të dhënave nga Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijëve 2.0, në Kosovë janë rreth 20,000 fëmijë me aftësi të kufizuara. Në Komunën e Podujevës sipas të dhënave të pranuar nga Qendra për Punë Sociale, zyrtarisht janë rreth 89 fëmijë me aftësi të kufizuara. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2022 thekson se fëmijëve me aftësi të kufizuara u mungon qasja e duhur në objektet e arsimit, si dhe asistencë e nevojshme sociale. Raporti thekson se “Autoritetet duhet të rrisin mbështetjen financiare për të zgjeruar shërbimet shoqërore dhe shëndetësore në nivel komuniteti për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të intensifikojnë përpjekjet për t'i integruar ata efektivisht në institucionet arsimore.”

Raporti i Monitorimit të KOMF tregon që edhe gjatë vitit 2021, QPS-të kanë vazhduar të kenë qasje reaktive sa i përket matjes së cënueshmërisë në komunat ku veprojnë.²² Asnjë QPS në komunat e monitoruara, nuk ka pasur mundësi dhe kapacitet që të dalë në terren dhe të bëjë vlerësimin e qytetarëve në nevojë.²³ Raportet e monitorimit nga KOMF theksojnë se QPS-të nuk kanë pasur financim të veçantë nga komunat të dedikuara vetëm për shërbime sociale dhe se komunat kryesisht kanë mbuluar pagat mujore dhe shpenzimet administrative për QPS-të, duke mos ndarë buxhet për

²⁰ Rrjeti i Grave të Kosovës, [Analiza Gjinore e Kosovës](#), 2018, fq.12

²¹ Po aty.

²² Po aty, fq.9

²³ Po aty.

QPS-të, për ofrimin e shërbimeve sociale bazuar në nevojat e qytetarëve brenda komunave.²⁴ I njëjti burim thekson se në të gjitha komunat, buxheti aktual nuk plotëson as për së afërmi nevojat reale për shërbime sociale, kjo edhe për faktin se mungon planifikimi i bazuar në nevoja.

Andaj OPED, synon që përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Strategjie (2024-2027), të fitojë licencën në ofrim të disa shërbime të nevojshme dhe të përshtatshme për fëmijët me nevoja të veçanta. Disa prej shërbimeve të nevojshme për këtë kategori të fëmijëve janë shërbimi i fizioterapisë, logopedisë dhe ai psiko-social. Të gjitha këto shërbime që janë të domosdoshme për këtë kategori të fëmijëve kanë një kosoto thuajse të pa përballueshme edhe krahas përkrahjes financiare që marrin nga QPS.

Njëherit, OPED do të vazhdojë të avokojë për politika më të ndjeshme sociale, përfshirë në aspektin gjinor, dhe të avokojë për hapjen e një qendre në komunën e Podujevës, ku të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta, mund të marrin shërbimet e nevojshme dhe të përshtatshme pa pagesë.

SFIDAT KRYESORE

Duke analizuar situatën ekzistuese dhe perceptimet e OPED nga puna në terren, zbatimi i kësaj objekte të përgjithshme mund të hasë në sfidat si në vijim:

- Mungesë e vullnetit politik në nivel komunal për të organizuar konsultime publike gjithëpërfshirëse, duke kontribuar drejt ngritjes së nivelit të demokracisë.
- Mungesë e njohurisë së zyrtarëve komunalë për aplikim të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, dhe për zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore në nivel lokal;
- Mungesa e të dhënave mbi numrin, situatën, nivelin e qasjes dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë nga perspektiva gjinore në komunën e Podujevës.
- Niveli i ulët i vetëdijësimit tek institucionet dhe ofruesit e shërbimeve mbi zhvillimin e politikave dhe programeve cilësore të cilat përdorin një qasje gjithëpërfshirëse dhe të fokusuar në fëmijën, në dhënien e shërbimeve sociale.
- Mungesa e shërbimeve/programeve alternative të ndjeshme për adresimin e nevojave të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara dhe që kanë karakter permanent, vështirësitë në qasje të shërbimeve ekzistuese dhe mungesa e teksteve në brail dhe në audio janë identifikuar si shkaktarët kryesorë të nivelit të lartë të analfabetizmit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

PËRFITUESIT, PARTNERËT DHE PËRKRAHËSIT

Përmes këtij objekti, përfitues kryesorë pritet të jenë fëmijët djem dhe vajza, gratë e komunës së Podujevës, personat me aftësi të kufizuara, të cilët do të përfitojnë nga shërbime të përmirësuara sociale, të përshtatura ndaj nevojave të tyre, dhe qytetarët në përgjithësi, të cilët do të kontribuojnë në ngritjen e demokracisë në nivel lokal. Partnerë në lidhje me jetësimin e kësaj objekte do të jenë: institucionet lokale komunale – përkatësisht drejtoria për shëndetësi dhe punë sociale, drejtoria e financave, zyrtarët për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore, qendrat për punë sociale, dhe shoqëria civile. OPED vlerëson se donatorë të ndryshëm me të cilët OPED vetem se ka zhvilluar marrdhënie bashkëpunimi do të jenë edhe partnerë edhe përkrahës së implementimit të kësaj objekte.

²⁴ Po aty.

STRATEGJIA E OPED

Përmes këtij objektiwi të përgjithshëm, OPED synon të targetojë zbatimin e ligjit në nivel lokal, duke monitoruar tri fusha kyqe, të cilat i kontribuojnë së bashku zbatimit të ligjit, llogaridhënies dhe drejtësisë sociale:

- Demokracinë
- Barazinë Gjinore
- Shërbimet sociale

Në lidhje me demokracinë dhe llogaridhënien, OPED synon të monitorojë nivelin komunal në sigurimin e qasjes gjithëpërfshirëse drejt politikë-bërjes dhe hartimit të Strategjive në nivel komunal, duke siguruar pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave të komuniteteve të ndryshme.

Në lidhje me barazinë gjinore, OPED do të synojë të monitorojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në nivel lokal, me theks aplikimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor, konsultimin e zyrtares për Barazi Gjinore në politikëbërje, përfshirjen e grave të ndryshme të zonave rurale dhe urbane në dëgjime publike, këshilla të fshatrave, sesione informuese, etj.

Fuqizimi Ekonomik i Grave vetëm se luan një rol kyq në veprimtarinë e OPED-së. OPED veçse është e angazhuar në asistimin e grave drejt të bërit biznes, përfshirë duke ofruar ekspertizë në dhënien e këshillave, përpilim të planeve të biznesit, ndërmjetësim në karrierë, konsultim të grave në lidhje me prioritetet e tyre dhe nevojat drejt të bërit tregti apo biznes, në organizimin e panairove të ndryshme dhe ndërmjetësimit në karrierë. OPED do vazhdojë me këtë veprimtari edhe në kuadër të kësaj strategjie, duke mbajtur të dhëna të ndara me bazë gjinore të grave përfituese nga iniciativat drejt fuqizimit ekonomik të grave.

Në lidhje me shërbimet sociale të cilat u ofrohen fëmijëve me aftësi të kufizuara, OPED synon të sigurojë që ofruesit e shërbimeve janë duke aplikuar qasje të ndjeshme gjinore dhe qasje e cila e vë në fokus fëmijën.

OPED synon të vë në plan të parë të kësaj objektive fëmijët me aftësi të kufizuara në Komunën e Podujevës, duke përfshirë fëmijë me probleme në zhvillimin mendor, fëmijë me probleme në folje, dhe fëmijë me aftësi të kufizuara fizike. Për këtë grup, OPED planifikon të ngrisë kapacitetet e veta drejt marrjes së licencës për ofrimin e shërbimeve profesionale për fëmijë, duke krijuar një ekip profesionist, i cili përmes vizitave të kryera në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për familjet e tyre do t'i kontribuojë dhënie së shërbimeve sociale në një kosto më të përballueshme. Tutje, OPED synon edhe të monitorojë shërbimet aktuale sociale, të cilat u ofrohen fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunën e Podujevës.

OPED poashtu synon të targetojë edhe autoritetet komunale, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me nevojat e kësaj kategorie të stigmatizuar. Këtë ndërgjegjësim synojmë t'a ngrisim përmes avokimit të vazhdueshëm, monitorimit të politikave ekzistuese sociale në nivel lokal dhe hartimit të politikave të reja, si dhe duke rritur bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile për të ofruar shërbime të integruara. Kjo do të ndikojë tek autoritetet lokale që të krijojnë një qasje më proaktive, më mbështetëse dhe më bashkëpunuese me palët e treta si ofrues të këtyre shërbimeve.

Gjithashtu OPED do të sigurohet që të integrojë në kuadër të kësaj objektive qasjen ndërthurëse, duke pasur parasysh nevojat e ndryshme të vajzave dhe djemve, në kuadër të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në kuadër të aktiviteteve dhe planeve të veprimit.

Objektivat	Rezultatet e pritura	Indikatorët
Objektivi 1.1 Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve në procese politikë-bërëse	1.1.1 Më shumë iniciativa të përbashkëta avokuese me organizata lokale të shoqërisë civile, për qeverisje më transparente, në nivel lokal, të realizuara 1.1.2 Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve gra dhe burra, shoqërisë civile, në konsultime dhe tubime publike	1.1.1 # i iniciativave të përbashkëta avokuese me organizata lokale të shoqërisë civile, për qeverisje më transparente, në nivel lokal 1.1.2 # i qytetarëve gra dhe burra, të cilët marrin pjesë në konsultime dhe tubime publike, falë asistimit të OPED-së
Objektivi 1.2 Përmirësimi i monitorimit dhe zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore në Nivel lokal	1.2.1 Ngritja e nivelit të përfshirjes së barabartë të grave dhe burrave, në procese vendim-marrëse dhe politikë-bërëse 1.2.2 Ngritja e nivelit të përfshirjes së grave në fushën e biznesit, tregtisë dhe punësimit 1.2.3 Ngritja e nivelit të zbatimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm gjinor në nivel komunal 1.2.4 OPED është aktivisht e përfshirë në konsultimet publike vjetore mbi buxhetin komunal, përfshirë në aplikimin e BPGJ-së	1.2.1 # i grave dhe burrave pjesëmarrë në procese vendim-marrëse dhe politikë-bërëse, falë avokimit të OPED-së 1.2.2 # i iniciativave të OPED-së për fuqizimin ekonomik të grave (numri i panairëve të organizuara, këshillimit individual, asistimit në përpilim të planeve të biznesit, ndërmjetësim në karrierë etj) 1.2.3 # i hapave të ndërmarrë nga komuna e Podujevës, për të aplikuar BPGJ-në, përfshirë duke konsultuar gra dhe burra të ndryshëm 1.2.4 # i konsultimeve dhe tubimeve publike në të cilat OPED merr pjesë në lidhje me konsolidimin e buxhetit vjetor komunal, duke avokuar për BPGJ-në
1.3 Përmirësimi i monitorimit, hartimit dhe zbatimit të politikave sociale në nivel komunal	1.3.1 Ndërmirren hapat institucionalë për përmirësimin e shërbimeve sociale, si rrjedhojë e monitorimit të OPED-së. 1.3.2 Ngritet vetëdija e institucioneve komunale në lidhje me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara	1.3.1 # i hapave të ndërmarrur institucionalë për përmirësimin e shërbimeve sociale, si rrjedhojë e monitorimit të OPED-së. 1.3.2 # i iniciativave avokuese të ndërmarrura për ngritjen e vetëdijes së institucioneve komunale në lidhje me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 2: AVANCIMI PROFESIONAL DHE EDUKIMI JOFORMAL I TË RINJVE NË NIVEL LOKAL

BAZA LIGJORE

Ligji i punës Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Sipas Nenit 1 të këtij ligji, qëllimi i tij është të rregullojë sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut, duke shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës. Ky ligj rregullon strukturën, organizimin dhe menaxhimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional.

Strategjia për Rininë 2019 - 2023 përfshirë planin e veprimit është një strategji gjithëpërfshirëse e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të rinjtë. Ajo ka për synim përmirësimin e situatës së të rinjve të grup-moshave 15 - 24 vjeç, duke përfshirë të gjitha palët e interesit si nga sektori qeveritar ashtu edhe nga ai joqeveritar. Strategjia gjithashtu synon të nxitë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore veprimtaria e të cilave lidhet me rininë, si dhe ndërmjet organizmave qendrorë dhe atyre komunalë për të fuqizuar politikën dhe programet rinore.²⁵

SITUATA

Sipas Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2022-2026, punësimi në Kosovë përveç se vazhdon të jetë i ulët, vazhdon të jetë jo i barabartë. PKZMSA thekson se sipas të dhënave të fundit, niveli më i lartë i punësimit ishte tek burrat (42.8%), ndërsa punësimi i grave ishte 15.9%. Gratë janë të punësuar, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 53.0%, ndërsa burrat janë kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimit, tregtisë dhe prodhimit, me 43.1%. Kosova ka shkallën më të ulët të punësimit të grave në Ballkanin Perëndimor.²⁶

Punësimi i të rinjve është shumë i lartë në Kosovë. Në tremujorin e parë të vitit 2021, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë mundësi të ishin të papunë në krahasim me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeç dhe të forcës punëtore, 48.6% ishin të papunë.

Tutje, transformimi digjital është duke përshkuar me shpejtësi Kosovën, sidomos pas pandemisë COVID-19. Si i tillë, ky transformim po kërkon nga vajzat dhe djemtë e rinj, gratë dhe burrat, që të jenë të përditësuar me teknologjitë më të reja informative në raport me çdo aspekt të të funksionuarit, qoftë në: punësim, përfitim nga shërbimet publike, trajnim dhe shkollim të mëtutjeshëm. Kosova tash rishtazi është duke hartuar një Projektligj mbi Rininë, ndërsa Strategjia vecse ekziston. Në Korrik 2023, qeveria e Kosovës poashtu miratoi Agjendën Digjitale 2030, e cila aftësimin dhe trajnimin e të rinjve në fushat digjitale i ka disa nga objektivat specifike.²⁷ Ndërkaq, në Komunën e Podujevës, mungon infrastruktura e nevojshme ku të rinjtë do të mund të shkëmbejnë apo përfitonin njohuritë për t'i rritur aftësitë e tyre në këtë fushë. Poashtu edhe në hapësirat e shkollave, ka mungesë të paisjeve dhe mundësisë për ngritje të kapaciteteve në këtë drejtim. Sipas Planit Strategjik të arsimit Në Kosovë 2017 – 2021, është konsideruar se sistemi arsimor karakterizohet me një përdorim të ulët të teknologjisë së informimit dhe komunikimit (TIK) dhe teknologjia bashkëkohore nuk është e

²⁵ Republika e Kosovës, Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit, [Strategjia për Rininë 2019-2023](#)

²⁶ Kvinna Till Kvinna, [The Women's Rights in Western Balkans Report \(2022\)](#)

²⁷ Qeveria e Kosovës, Ministria e Ekonomisë, [Agjenda Digjitale 2030](#)

integruar si duhet në kurrikulë, mësimdhënie apo në menaxhim të arsimit.²⁸ Edhe pse mungojnë të dhëna mbi përfshirjen e saktë të të rinjve në fushën e TIK, për arsye se një pjesë e mirë e tyre janë të punësuar në kompani jashtë vendit, të rinjtë djemë dhe vajza nuk janë duke marrë sa duhet ngritje të kapaciteteve në raport me profesionet më inovative të cilat po i kërkon tregu global i punës: Programues (zhvillues të programeve), Administratorë të sistemit, Analistë të bazave të të dhënave, Dizajner grafik e tjera. Shkollat profesionale nuk kanë kapacitetet e duhura të ofrojnë programe nga këto profile, që nënkupton se përgatitja profesionale e të rinjve nuk përkon me mundësitë potenciale të tregut të punës. Tutje, meqenëse programet inovative nga këto fusha janë më së shumti të centralizuara në Prishtinë, të rinjtë e Podujevës rrezikojnë të mbesin prapa me avancimin e njohurive të tyre digjitale.

SFIDAT KRYESORE

Nga puna në terren dhe nga përvoja me projektet paraprake, OPED, si sfida kryesore në implementimin e kësaj objektivë parasheh këto në vijim:

- Krijimi i një niveli të theksuar të komunikimit me akterët relevant komunalë, përkatësisht, me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe/apo qendrat për aftësim profesional në mënyrë që të kemi një koordinim dhe bashkëpunim drejt ndërthurjes apo kombinimit të edukimit formal dhe atij joformal që OPED do të tentojë të ofrojë.
- Krijimi i një bashkëpunimi të theksuar me sektorin e biznesit, duke i bindur ata të investojnë dhe të bëhen pjesë e iniciativave edukative joformale për të rinjtë dhe të rejtat.
- Sigurimi i trajnerëve profesionistë të fushës, të cilët brenda një buxheti të caktuar, pranojnë të ofrojnë trajnime në fushat e identifikuar.

PÛRKRAHËSIT DHE PÛRFITUESIT

PÛrkrahës kryesorë të OPED-së parashihet të jenë autoritetet komunale, përkatësisht, drejtoria e Arsimit, Shkollat, Komuniteti i bizneseve dhe donatorët. Ndërsa pÛrfitues nga kjo objektivë do të jenë të rinjtë dhe të rejtat e komunës së Podujevës, nga mosha 14-29 vjeç.

STRATEGJIA E OPED

Strategjia e OPED-së në lidhje me arritjen e objektivit të pÛrgjithshëm Objektiva 2: Avancimi profesional dhe edukimi joformal i të rinjve në komunën e Podujevës, do të realizohet në kuadër të indikatorëve, objektivave specifike dhe rezultateve të pritura si në vijim:

Objektivat	Rezultatet e pritura	Indikatorët
2.1 PÛrmirësimi i ndërmjetësimit në karrierë i të rinjve burra dhe gra në nivel lokal	2.1 Rritet numri i të rinjve të vetëdijësuar për mundësi të e punësimit	2.1.1 # i të rinjve të vetëdijësuar për mundësi të punësimit, i ndarë në të dhëna me bazë gjinore (# gra, # burra)
2.2 Rritja e mundësive për edukim joformal i të rinjve burra dhe gra në fusha innovative të tregut të punës	2.2 Rritet numri i të rinjve të edukuar, trajnuar, në fusha innovative të tregut të punës	2.2.2 # i të rinjve të edukuar apo trajnuar në fusha innovative të tregut të punës (Teknologji Informative, Programim, Dizajn Grafik, apo të tjera) , i ndarë në të dhëna me bazë gjinore (# gra, # burra)

²⁸ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, [Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021](#)

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 3: PËRMIRËSIMI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE TË GJELBËRTA

BAZA LIGJORE

Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Sipas Nenit 1, ky ligj ka për qëllim: të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private; të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private; garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (në tekstin e mëtejshëm VNM) - nënkupton procesin i cili përfshin edhe realizimin e konsultimeve me publikun sipas nenit 16 të këtij ligji.

Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Qëllimi i këtij ligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.²⁹

Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian. Neni 2 i këtij ligji thekson se ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.³⁰

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm Në vitin 2015, liderët botërorë miratuan Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, duke premtuar eliminimin e varfërisë së skajshme, uljen e pabarazisë dhe krijimin e një planeti më të gjelbër. Agjenda 2030 përfshin 17 Synime Globale të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-të). Kosova ka pranuar me vullnet të lirë Rezolutën Nr. 06-R-001 mbi Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe gjithashtu për themelimin e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Këshilli përbëhet nga deputetë, përfaqësues nga administrata, shoqëria civile, zyra e Kryeministrit, Agjencia e Statistikave e Kosovës, Asociacioni i komunave të Kosovës dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. OZHQ-të, ndër tjera, përfshijnë edhe : 13.Veprimin për klimën, 14.Jetën nën ujë 15.Jetën në tokë.

SITUATA

Raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën thekson se Kosova nuk ka shënuar ndonjë përparim të ndjeshëm në fushat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Raporti poashtu thekson se Kosova ka nevojë të rritë ndjeshëm ambiciet dhe kapacitetet administrative për të zbatuar saktë standardet e BE-së në transport, energji dhe mjedis, duke kërkuar që strategjitë, planet vepruese dhe ligjshmëria në këto sektorë të jenë më konsistentë dhe në përputhje me parimet dhe objektivat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe Planin Ekonomik dhe të Investimeve.³¹

²⁹ Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

³⁰ Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit

³¹ European Commission, Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, Kosovo Report 2022, 12 October 2022

Mbrojtja e mjedisit, përkatësisht, e ujërave, është një nga rrethanat të cilat i kanë kontribuar nevojës për themelimin të kësaj organizate. OPED vazhdimisht ka qenë e ekspozuar ndaj kërkesave të banorëve të Komunës së Podujevës gjegjësisht të fshatit Orllan dhe 11 fshatrave përreth, për furnizim me ujë të pijshëm. Edhe përkundër mungesës së fondeve, OPED ka ndërmarrë shumë veprime avokuese, që kanë rezultuar në arritjen e qëllimit, që të realizohet projekti i furnizimit me ujë të pijshëm. Sidoqoftë OPED vlerëson se niveli i ndërgjegjshmërisë qytetare për të punuar drejt mbrojtjes së ambientit është i ulët. Njëherit, ky nivel i ulët i vetëdijes në lidhje me mbrojtjen e ambientit dhe nevojës për më shumë politika të gjelbërta e vështirëson llogari-dhënien komunale, lokale, në implementim të politikave të tilla. Diskutimet për njohjen e këtij konteksti, poashtu mungojnë, edhe pse ka interesim për aktivizëm brenda komunitetit.

Përkundër obligimeve ligjore që edhe niveli lokal ka drejt mbrojtjes së ambientit, rrjedhimisht, mbrojtjes së ujërave, OPED ka vëzhguar përgjatë projekteve të kaluara se të njëjtit nuk ndërmarrin veprime konkrete në ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave në teritoret e tyre administrative. Njëherit, mungon monitorim i vazhdueshëm i zyrtarëve komunalë në hartimin por edhe zbatimin e politikave të gjelbërta, drejt harmonizimit me qëllimet e Objektivave të Qëndrueshëm. Komunitet poashtu nuk kanë ndonjë Plan të Veprimit apo Strategji konkrete mbi bazën e së cilës do të mund të orientonin planifikimet buxhetore për përmirësimin e gjendjes së ujërave. Njëherit, përkundër pozitës së mirë gjeografike të Podujevës dhe trashëgimisë së saj kulturore, iniciativat për të vënë në shprehje potencialin e saj kulturore dhe turistik janë të rralla.

Andaj është i nevojshëm kontributi në ndërgjegjësimin dhe ngritjen e vetëdijes së qytetarëve së pari në kuptim dhe monitorim të politikave pro ambientit, dhe tutje, për të monitoruar hartimin apo zbatimin e politikave dhe Strategjive komunale drejt mbrojtjes së mjedisit, gjë që do t'i bëjë komunitet më përgjegjës dhe proaktiv në ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave. Njëherit, është e nevojshme një iniciativë konsistente drejt promovimit të ekoturizmit dhe potencialit kulturor të komunës së Podujevës.

SFIDAT KRYESORE

OPED në bazë të përvojës në terren, dhe njohjes së kontekstit në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal, thekson se përgjatë implementimit të kësaj objektiviteti të përgjithshme, mund të paraqiten disa nga sfidat si në vijim:

- Mungesë e vullnetit të zyrtarëve komunalë për t'u angazhuar në hartim dhe implementim të politikave të gjelbërta;
- Mungesë e vullnetit të qytetarëve që në mënyrë të vazhdueshme të monitorojnë komunitetin drejt implementimit të duhur të politikave të gjelbërta;
- Nivel i ulët i vetëdijes së qytetarëve, burra dhe gra, kundrejt rolit të tyre në raport me mbrojtjen e mjedisit;

PËRKRAHËSIT DHE PËRFITUESIT

Përkrahës kryesorë të OPED-së parashihet të jenë autoritetet komunale, përkatësisht, drejtoria e ambientit, komuniteti i fermerëve, të rinjtë dhe organizatat joqeveritare lokale apo qëndrore, si dhe donatorët. Përfitues nga kjo objektiviteti e përgjithshme parashihet të jenë qytetarët burra dhe gra të komunës së Podujevës, së cilëve do t'u përmirësohet kualiteti jetësor në kuadër të avokimit të OPED për më shumë politika të gjelbërta në nivel lokal.

STRATEGJIA E OPED

Me anë të përvojës së krijuar, OPED do të tentojë t'i minimizojë sfidat e përmendura më lart. Organizata OPED me bazë është e vendosur në fshatin Orllan, i cili njihet si zonë e Liqenit të

Batlavës. Prandaj, mbrojtja e mjedisit duke pasur në fokus mbrojtjen e ujit të pijshëm, paraqet edhe një nga objektivat kryesore të kësaj strategjie.

OPED do të synojë të përmirësojë kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar në mënyrë efektive progresin e politikave mjedisore në qeverisjen lokale. Kjo përfshin fuqizimin e grupeve të shoqërisë civile me njohuri, aftësi dhe burime të nevojshme për të angazhuar në aktivitete monitoruese të politikave në favor të mbrojtjes së mjedisit.

Mes tjerash, OPED synon t'a bëjë një gjë të tillë përmes:

- Zhvillimit të punëtorive trajnuese dhe programeve për rritjen e kapaciteteve për qytetarë dhe anëtarë të shoqërisë civile mbi analizën e politikave mjedisore, mbledhjen e të dhënave dhe metodologjitë e monitorimit.
- Bashkëpunimit me nivelin komunal në lidhje me sigurimin e qasjes në informacione, të dhëna dhe burime relevante lidhur me politikat mjedisore, legjislacionin dhe proceset e qeverisjes.
- Themelimin apo promovimin e hapësirave dhe platformave bashkëpunuese ku qytetarët mund të ndajnë përvoja, praktika më të mira dhe mësimet të nxjerra në monitorimin e politikave mjedisore.
- Avokimin për përmirësimin e politikëbërjes që promovon transparencën, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe qasjen e publikut në informacione mjedisore.
- Avokimin për vendosjen e kanaleve zyrtare për raportim të rregullt dhe të standardizuar mbi progresin e zbatimit të politikave mjedisore;
- Inkurajimin e autoriteteve lokale të qeverisjes për të publikuar raporte të konsoliduara mbi progresin e politikave mjedisore, duke përfshirë veprimet specifike të ndërmarrura dhe rezultatet e tyre. Raportet e tilla do të kërkohet të jenë të lehtësisht të arritshme për publikun, idealisht përmes platformave në internet ose bibliotekave publike, për të siguruar shpërndarjen e gjerë të informacionit.
- Përdorimin e procesit të konsultimeve publike dhe mekanizmave tjerë konsultues përfshirë në nivel qendror dhe lokal për të dhënë kontribute & rekomandimet, në kuadër të së cilave shoqëria civile dhe qytetarët burra e gra do të shqyrtojnë raportet e zbatimit të politikave, të japin pyetje dhe të japin kontribute për përmirësimet e mëtejshme. Psh: Organizimit të dëgjimeve publike së bashku me Kuvendet Komunale me qëllim të mbledhjes së të dhënave, sugjerimeve dhe rekomandimeve që duhet të merrën parasysh gjatë krijimit të Strategjive apo politikave të tjera në favor të ambientit.
- Duke ndjekur këta objektiva, organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e qeverisjes lokale për progresin dhe rezultatet e politikave mjedisore. Raportimi transparent dhe angazhimi aktiv me shoqërinë civile mund të çojë në politika mjedisore më efektive dhe në fund të fundit të kontribuojë në mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë më të mirë të mjedisit në nivel lokal.
- Takime të përafërta konsultuese me komunitetin e fermerëve/bujqve, me qëllim të diskutimit të alternativave të mundshme të shfrytëzimit të ujit për ujtime, si dhe të shfrytëzimit sa më racional të ujrave.
- Takime me të rinjtë – do të organizohen takime me të rinjtë/nxënësit me qëllim të vetëdijesimit të tyre për rëndësinë dhe mbrojtjen e ujrave që posedon vendi ynë.

Objektivat specifike, rezultatet e pritura dhe indikatorët në lidhje me Objektivin e përgjithshëm: Përmirësimi i zbatimit të politikave të gjelbërta për vitet 2024-2027 janë të renditura detajisht më poshtë.

Objektivat	Rezultatet e pritura	Indikatorët
------------	----------------------	-------------

Objektivi 3.1. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe shoqërisë civile për rëndësinë e monitorimit të politikave mjedisore	3.1.1 Ngritja e kapaciteteve të qytetarëve dhe anëtarëve e shoqërisë civile mbi analizën dhe monitorimin e politikave mjedisore 3.1.2 Më shumë hapësira dhe platforma bashkëpunuese ku organizatat e shoqërisë civile mund të ndajnë përvoja, praktika më të mira dhe mësimet të nxjerra në monitorimin e politikave mjedisore, të funksionalizuara	3.1.1 # i punëtorëve trajnuesë dhe programeve të mbajtura nga OPED për rritjen e kapaciteteve për qytetarët dhe anëtarët e shoqërisë civile mbi analizën e politikave mjedisore, mbledhjen e të dhënave dhe metodologjitë e monitorimit. 3.1.2 # i diskutimeve të mbajtura në hapësirat dhe platformat bashkëpunuese me komunitetin (numri i pjesëmarrësve në diskutime do të jetë i ndarë në baza gjinore - #burra dhe #gra)
Objektivi 3.2. Përmirësimi i monitorimit dhe promovimit të raportimit transparent dhe për zbatimin e politikave mjedisore	3.2.1 Rritja e iniciativave avokuese të ndërmarra për vendosjen e kanaleve zyrtare për raportim të rregullt dhe të standardizuar mbi progresin e zbatimit të politikave mjedisore nga niveli komunal 3.2.2 Rritja e numrit të dokumenteve të monitoruara dhe komentuara nga OPED, nga perspektiva e mbrojtjes së ujërave dhe mjedisit	3.2.1 # i iniciativave avokuese të ndërmarra për vendosjen e kanaleve zyrtare për raportim të rregullt dhe të standardizuar mbi progresin e zbatimit të politikave mjedisore nga niveli komunal 3.2.2 # i dokumenteve të monitoruara nga OPED, nga perspektiva e mbrojtjes së ujërave dhe mjedisit.
3.3 Përmirësimi i promovimi i qasjes së eko-turizmit në komunën e Podujevës	3.3.1 Rritet numri i të rinjve të komunës së Podujevës të përfshirë në alternativa joformale të edukimit mjedisor 3.3.2 Ngritet vetëdija shoqërore për potencialin e komunës së Podujevës për Ekoturizëm dhe zhvillim ekonomik lokal	3.3.1 # i të të rinjëve, djemë dhe vajza, të përfshirë në alternativa joformale të edukimit të organizuara nga OPED 3.3.2 # i analizave të politikave të realizuara mbi potencialin e komunës së Podujevës për ekoturizëm dhe të shpërndara nëpër rrjete të ndryshme të promovimit social e mediatik

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 4: NGRITJA E KAPACITETEVE TË OPED

BAZA LIGJORE

Statuti i OPED përcakton se OPED angazhohet në aktivitete të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes shoqërore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mes tjerash, drejt qeverisjes demokratike dhe ngritjes së demokracisë institucionale.

SITUATA

Përgjatë viteve të veprimtarisë së vet, OPED ka kontribuar në jetësimin e qëllimeve të përcaktuara në Statut, në kuadër të projekteve dhe iniciativave të cilat kanë prekur çështje të ndryshme me interes shoqëror, si psh. të tillat në vijim:

- Projekti “Aktivizmi qytetar dhe institucional në përmirësimin e gjendjes së mjedisit për ujë cilësor”. - Përkrahur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor;
- Projekti “Qytetari aktive për transparencë dhe llogaridhënie në qeverisjen lokale”. - Përkrahur nga Fondet e Bashkimit Evropian dhe menaxhuar nga IKS, Lens dhe FES;
- Projekti “Aftësimi në gastronomi dhe dizajn mundësi punësimi për të rinjtë”. - Përkrahur nga (ish) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Projekti “Aftësimi i të rinjve në Programim” - përkrahur nga Komuna e Podujevës;
- Projekti “Aktivizmi qytetarë për mjedis të shëndetshëm” Përkrahur nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Projekti “Mobilizimi rinor në parandalim të ekstremizmit” përkrahur nga fondet e Bashkimit Evropian, menaxhuar nga Forum MNE;

Përkundër diversitetit dhe angazhimit në tema të ndryshme dhe përvojës së theksuar të OPED në terren & avokim, ekziston nevoja për të ngritur kapacitetet profesionale të stafit të OPED-së në fusha të ndryshme, ashtu që OPED të vazhdojë rrugëtimin ku e sheh veten në të ardhmen. Me qëllim të stabilitetit më të madh financiar të organizatës OPED duhet të punoj të në rregullimin e brendshëm dhe qasjen në dokumentacion adekuat për realizimin e projekteve, por edhe promovimin e tyre. Dokumentacioni adekuat përfshin por nuk limitohet në manuale për prokurim dhe financa, manualin e burimeve njerëzore, rregulloren e punës, krijimin e web-faqes zyrtare ku ndahen me publikun aktivitetet, puna, hulumtimet dhe analizat e politikave, por edhe realizimi i kampanjave për avokim në çështje të caktura. Stafi i OPED-së duhet të trajnohet në përpilimin e analizave të politikave dhe hulumtimeve, drejt paraqitjes sa më korrekte dhe reale të gjetjeve të monitorimit të cilin OPED e realizon në raport me fushat e identifikuara në kuadër të kësaj Strategjie.

SFIDAT KRYESORE

Deri më tani, përkundër njohurive të stafit të OPED-së, organizata në realizimin e hulumtimeve dhe analizave është mbështetur relativisht në ekspertë të jashtëm dhe hulumtues të jashtëm. Ngritja e kapaciteteve të stafit të OPED-së në hulumtim dhe shkrim të analizave të politikave do të bënte të mundur avokim më të suksesshëm dhe informues të institucioneve, kundrejt politikë-bërjes së bazuar në dëshmi. Hulumtimet e OPED-së poashtu do t'i kontribuonin ngritjes së vetëdijes së përgjithshme shoqërore në lidhje me çështjet e gjurmara, me theks përfshirjen e grave në politikë-bërje, nivelin e zbatimit të nivelit lokal të politikave të gjelbërta, kualitetin e shërbimeve sociale, nivelin e transparencës dhe demokracisë etj.

Njëherit, kapacitetet e OPED për ngritje fondesh dhe marrëdhënie me publikun poashtu mund të përmirësohen, për shkak se OPED ende nuk ka kanale të sofistikuara dhe të përditësuara për të arritur të ndikojë audienca të ndryshme, përmes ndarjes së sukseseve dhe iniciativave avokuese. Andaj, një hapësirë e tillë do të tentohet të adresohet poashtu përmes këtij objekti strategjik.

PËRKRAHËSIT DHE PËRFITUESIT

Përkrahës kryesorë të OPED-së në realizimin e kësaj objektive do të jenë donatorët e mundshëm, në kuadër të së cilëve do të bëhet e mundur ngritja e kapaciteteve të brendshme. Përfitues do të jenë stafi i OPED-së.

STRATEGJIA E OPED-SË

Përmes këtij objekti të përgjithshëm, OPED synon të angazhojë ekspertë të jashtëm të hulumtimit, të cilët do të trajnojnë stafin e OPED në shkrim të analizave të politikave dhe në metodat e hulumtimit.

Objektivat	Rezultatet e pritura	Indikatorët
4.1 Ngritja e kapaciteteve organizative të OPED	4.1 Përmirësohen dokumentet dhe politikat e brendshme të OPED-së 4.1.2 Ngriten kapacitetet e OPED për ngritje fondesh dhe marrëdhënie me publikun	4.1.1 # i dokumenteve dhe politikave të krijuara dhe rishikuara (rregullorja e punës, manuali financiar dhe i prokurimit, manuali i burimeve njerëzore, krijimi i data bazës së monitorimit dhe vlerësimit). 4.1.2 # i trajnimeve në strategjinë për ngritje fondesh dhe marrëdhënie me publikun (numri i pjesëmarrësve në diskutime do të jetë i ndarë në baza gjinore - #burra dhe #gra) 4.1.3 # i vizitorëve në web faqen e re të ribrenduar
4.2 Ngritja e kapaciteteve të brendshme të OPED-së për ofrimin e shërbimeve sociale	4.2 Mirret licenca nga departamenti për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ministria e Drejtësisë, për ofrimin e shërbimeve sociale	4.2.1 Licenca e marrur për ofrimin e shërbimeve sociale
4.3 Ngritja e kapaciteteve të OPED-së në përpilimin e hulumtimeve dhe analizave të politikave	4.3 OPED pajiset me njohuri të mjaftueshme mbi përpilimin e hulumtimeve dhe analizave të politikave	4.3.1 # i trajnimeve të ndjekura nga stafi i OPED-së mbi metodat e hulumtimit (numri i pjesëmarrësve në diskutime do të jetë i ndarë në baza gjinore - #burra dhe #gra) 4.3.2 # i trajnimeve të ndjekura nga stafi i OPED-së mbi përpilimin e Analizave të Politikave (numri i pjesëmarrësve në diskutime do të jetë i ndarë në baza gjinore - #burra dhe #gra)